

## HYRTORET E MESHES

### HYRTORJA E TË DIELAVE

Ejani ti fálemi dhe ti pergjúnjemi Zotit Krisht. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-ngjalle se vdékuresh, né qe te kendojme Alilluja.

*Kjo Hyrtore kendohet te Díelave dhe ne mes te javes me perjashtimet, qe pasojne:*

### HYRTORJA E SHENJTORËVE

Ejani ti fálemi dhe ti pergjúnjemi Zotit Krisht. Shpetona, o i Bir' i Perendise, o i çudiçim ner Shenjtoret, né qe te kendojme Alilluja.

*Kjo Hyrtore kendohet ne te gjitha te kremtet e Shenjtóreve te shenuar, si edhe te Shen Marise me perjashtimin e Ungjillezimit.*

### HYRTORJA E LARTËSIMIT TË KRYQIT

Lartësoni Zotin Perendine tone, dhe fáluni ne-ne kembet e tij. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-kryqesove truperisht, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E KËRSHËNDELLAVE

Prej gjirit te kam lindur perpara Driteprúresit; Zoti u-betua dhe nukë do pendohet; ti je Prift per jete pas úrdherit Melkishedék. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe linde prej Virgjereshes, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E MOTIT TË RI

Ejani ti fálemi dhe ti pergjúnjemi Zotit Krisht. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-rethpreve mishërisht, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E EPIFANISË

I bekuar esht aý qe vjen, me émerin e Zotit; Perendí dhe Zot, permi dhene na u-çfaq. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-pagezove prej Joanit ne Jordán, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E PERHASJES

Zoti e çfaq shpetimin e tij perpara gjithë kómbeve. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-mbajte ne peqirin e Simeonit te drejte, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E UNGJILLEZIMIT

Ungjillezoni dite per dite shpetimin e Perendise tone. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-mishero-ve per né, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E PALLMAVE

I bekuar esht aý qe vjen, me émerin e Zotit; Perendí dhe Zot, permi dhene na u-çfaq. Shpetona,

o i Bir' i Perendise, qe hipe mi nje kafshe te per-unjur, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E PASHKËS

Ner Kishet e bekoni Perendine, Zotin prej bu-rrimit t' Israelit. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-ngjalle se vdékuresh, né qe te kendojme Alilluja.

*Kjo Hyrtore kendohet gjer ne Shestjen.*

## HYRTORJA E SHESTJES

U-ngjit Perendia me brohorí, Zoti me buçitje prej trumbete. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe fluturove ne qellin me lavdí, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E RUSHAJEVE

Lartesohu me fuqine tende o Zot; do ti kendojme dhe do ti psallim poterat e tua. Shpetona, o Ngushellimtar i mire, né qe te kendojme Alilluja.

## HYRTORJA E SHPERFYTYRIMIT

Thabori dhe Hermoni do te ngazellohen me emrin tent. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-shperfytyrove ne malin Thabór, né qe te kendojme Alilluja.